

SEKUENCIMI I PLOTË I GJENOMIT WGS

Sekuencimi i Plotë i Gjenomit (WGS)

Sekuencimi i Plotë i Gjenomit (WGS) është një teknikë e sekuencimit të ADN-së që shpreh përcaktimin e të gjithë materialit gjenetik të një organizmi, pra të gjithë gjenomit të tij. Kjo teknikë synon të përcaktojë të gjithë sekuencën e ADN-së së një individi ose organizmi. Kjo teknikë, në ditët e sotme, ka filluar të përdoret vitet e fundit në diagnostikimin e sëmundjeve dhe në kërkime për të përcaktuar variantet gjenetike. Përveç pacientëve tek të cilët është kryer sekuencimi i ekzomit por nuk kemi mundur të vendosim diagnozë, sekuencimi i gjenomit përdoret veçanërisht për të përcaktuar ndjeshmërinë ndaj barnave dhe për të kryer analiza haplotipi.

Në Cilat Sëmudjet Përdorët SekuencimiiPlotëiGjenomit (WGS) Për Diagnostikim / Zbulim?

Sëmudjet Monogjenike: Është një mjet efektiv në diagnostikimin e sëmundjeve gjenetike që varen nga një mutacion i vetëm gjenetik. Përdoret veçanërisht për të gjetur dhe kuptuar shkaqet e sëmundjeve të rralla gjenetike.

Kanceri: Analiza gjenomike e qelizave kancerogjene mund të kryhet me WGS. Kjo mund të përdoret për të përcaktuar rreziqet e kancerit familjar, për të përcaktuar llojin e kancerit, për të identifikuar objektiva potenciale dhe për të personalizuar strategjitë e trajtimit.

Variantet Gjenetike dhe Polimorfizmat: WGS është efektiv në përcaktimin e shumë varianteve të lehta dhe bartësive që gjenden tek individët. Kjo, kur polimorfizmat gjenetikë vlerësohen së bashku, mundëson përcaktimin e skorëve të rrezikut për shumë sëmundje. Mund të ofrojë zgjidhje për sëmundjet multifaktoriale dhe për sëmundjet, shkak i të cilave nuk është përcaktuar qartë.

Gjendjet e Bartësisë: WGS është një mjet i rëndësishëm në përcaktimin e sëmundjeve gjenetike për të cilat individi mund të jetë bartës. Ky informacion mundëson vendosjen e hershme të diagnozës për disa sëmundje që mund të shfaqen tek personi në moshë më të madhe dhe, nëse ka plane për martesë dhe fëmijë, bën të mundur planifikimin paraprak.

Rajonet Gjenetike me Riorganizim: WGS mund të jetë efektiv në përcaktimin e ndryshimeve në shkallë të gjerë në strukturën gjenetike. Mund të zbulohen gjendje si variacionet strukturore, ndryshimet kromozomale dhe translokacionet. (Shkalla e kapjes së këtyre ndryshimeve është më e lartë me sekuencimin e plotë të gjenomit me lexim të gjatë.)

Aplikimet Farmakogjenetike: WGS mund të përdoret për të përcaktuar faktorët gjenetikë që ndikojnë në metabolizmin e barnave tek individët. Kjo mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në aplikimet e mjekësisë së personalizuar.

**Për Njerëzimin Shëndet,
Shkencë Për Shëndetin!**

Adresa: Rr. Tirana "P.Residence" C4/2 L/E Nr13/a Prishtinë / KOSOVE
Telefoni: +383 46 102106 / +383 48 443 447
Uebfaqja: www.intergen.com.tr
E-mail: info@intergenks.com